

AKTI I THEMELIMIT

DHE STATUT

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“ Laser Dermatology Clinic “ sh.p.k.

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “ *Laser Dermatology Clinic “ sh.p.k.*, eshte themeluar nga ortaket:

- **Znj.Blerina Zeneli Gjinolli** , shtetas SHQIPTAR datl. 12/08/1985 , lindur ne Elbasan, mbajtes i ID me nr.I55812053F , madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar;

DISPOZITA TE PERGJITHSHME/Neni 1

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit .Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE/Neni2

Kabinet mjekesor per vizita dermatologjike. Sherbime ne fushen e estetikes , sherbime ne specialitete te ndryshme mjekesore, vizita, konsulta, kontrolle mjekesore, ekzaminime etj.

Shitje e produkteve dhe pajisjeve kozmetike. Import eksport te çdo produkti dhe paisjesh :kozmetik, estetike ,mjekesore ,sanitar perfshire dhe pajisje per trajtime estetike.

Ofrimin kurse te lira profesionale me eksperte te specializuar, te kete edhe keshillime nga ana e specialisteve te tjere, te jape me qira pjesisht ose teresisht te treteve ose shoqerive te tjera estetike ambientet e veta perfshire ketu edhe pajisjet; te kryeje kurse perditesimi dhe perfeksionimi ne dege te ndryshme te estetikes ne pergjithesi, te organizoje konferenca ne ceshtje profesionale; te lidhe kontrata keshillimi me eksperte te specializuar, te organizoje kurse formimi dhe perditesimi profesional, duke perdorur subjekte te afte per kete qellim

Bashkepunim me shoqeri te ndryshme, shqiptare dhe te huaja, qe kane objekt te njejte apo te perafert me ate te kesaj shoqerie... Aktivitetet e listuara me siper do te zhvillohen ne respektim te legjislacionit ne fuqi ne lidhje me aktivitetet profesionale, aktivitete konference, kurse formimi etj

SELIA E SHOQERISE/Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar“ *Laser Dermatology Clinic “ sh.p.k.*, ka seline e saj ne; *Rruga Asim Zeneli, Pallati 12, Kati 2, Apartamenti 4 Tirane*. Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

KOHEZGJATJA/Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise.

DETYRIMET E ORTAKEVE/Neni 5

Ortaket e shoqeriseduhet te kryeje depozitimn e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tij.

TRANSFERIMI I KUOTAVE/Neni 6

Ortaket e shoqerise mund te kaloje pjesen nga kapitali themeltar i personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 73 te ligjit 9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

PARAQITJA KONTABILE/Neni 7

Operacionet e shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit.

Ne mbyllje te cdo viti ortaket ose personi i ngarkuar prej tyre, ben inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe harton raport me shkrim.Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar.

KAPITALI THEMELTAR/Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqindmije) leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte si vijon :

Lloji i kontributiteshte ne para ne vleren 100 000 (njqindmije) leke, i ndare ne 1 kuota me vlere 100 000(njqindmije) leke ;

- **Znj. Blerina Zeneli Gjinolli** , eshte zoterues i 1 (nje Kuote) me vlere 100 000Lek (Njqindmije lek), qe korrespondon ne 100 % te Kapitalit te Shoqerise.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkruar teresisht nga ortaket e shoqerise.

OPERACIONET FINANCIARE

Neni 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucionevete kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

BLERJET E SHOQERIVE

Neni 10

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republikën e Shqipërisë, shoqeria gëzon të drejtën e saj për të zotëruar mjete të saj si në çdo shoqëri tjetër ose organizate tregtare, kombëtare shqiptare në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar

FONDI REZERVE

Neni 11

Shoqeria mund të themelojë një fond rezerve si dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin e tij.

Perberja, shuma totale, fondet për krijimin e tyre përdorimi dhe rregullimi i tyre (i çdo fondi) përcaktohet nga ortakët i vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale të shoqërisë raportohen në bilancë të shprehur në leke shqiptare, në përputhje me rregullat në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Bilanci dhe përlogaritjet ekonomike të shoqërisë hartohen mbi bazën e formës së bilancit dhe llogaritjeve ekonomike të përcaktuara për shoqëritë tregtare në Shqipëri. Bilanci vjetor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

PLANET FINANCIARE

Neni 12

Aktiviteti i shoqërisë mbi bazën e programeve financiare që bëjnë pjesë në aktivitetin financiar të saj. Planet financiare parashikojnë koston dhe të ardhurat e shprehura në leke shqiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do të paraqiten në leke shqiptare. Rezultatet financiare të aktivitetit dhe të punës së kryer nga shoqëria, paraqiten në bilancin vjetor. Kursi i këmbimit të monedhës shqiptare në monedhat e huaja dhe e kundërta do të jenë ato të vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

ORGANET E SHOQERISE

Neni 13

Organi vendimarrës i shoqërisë " *Laser Dermatology Clinic* " sh.p.k është asambleja e ortakëve e përbërë nga ortakët e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

Neni 14

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

MËNYRA E THIRRJES

Neni 15

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik

duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS

Neni 16

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

- a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;
- b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të statutit.

Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE

Neni 17

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e

përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe

mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

KUORUMI

Neni 18

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, date 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

MARRJA E VENDIMEVE

Neni 19

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, date 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË

Neni 20

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data e

mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

ADMINISTRATORI

Neni 21

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar administrohet nga një ose disa persona fizike. Administratori i shoqërisë emërohet me vendim të ortakut të shoqërisë. Afati i qëndrimit në detyrë të administratorit të shoqërisë është për një periudhë 5 (pese) vjetore.

- *Administratore të kësaj shoqërie është **Znj. Keti Kavaja** shtetas Shqiptar datl. 13/12/1977, , mbajtes ID, me nr. H76213102D , madhore, me zotesi të plote juridike dhe për të vepruar,*

Administratori i shoqërisë i ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat, me përjashtim të kompetencave që u njeh ligji shprehimisht Asamblesë së Ortakëve ose të tregëve. Administratorët kanë përgjegjësi ndaj shoqërisë ose ndaj të tregëve për shkeljetë ligjeve, statutit apo shkeljetë të kryera gjatë administratimit. Administratori në rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogaritë vjetore etj.

RASTET E PUNES

Neni 22

Raportet e punës ndërmjet shoqërisë, filialeve dhe agjensive të saj si dhe të punonjësve në të, rregullohen në bazë të kontratës së punës, konform Kodit të Punës.

Për sa nuk parashikohet në kontratën e punës, aplikohen dispozitat e legjislativës shqiptare në fuqi.

Neni 23

Shoqëria merr përsipër, të shlyejë rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislativës për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

PERFUNDIMI I AKTIVITETIT

Neni 24

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- 1.Me kalimin e afatit për kohezgjatjen e saj në kontratën e themelimit.
- 2.Për pamundësinë e realizimit të objektit të saj.
- 3.Me vendimin e gjykatës.
- 4.Me hapjen e procedurave të falimentit.

LIKUJDIMI

Neni 25

Likujdimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

KUSHTET E TJERA

Neni 26

Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakut te veten evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te bejne ortaket si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

- Per regjistrimin e shoqerise "*Laser Dermatology Clinic* " *sh.p.k* dhe depozitimim e akteve perkatese prane Qendres Kombetare te Regjistrimit, autorizohet **Znj.Keti Kavaja** shtetase Shqiptar, datl. 13/12/1977, lindur ne Tirane , mbajtes ID, me nr. H76213102D madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar,

Per shoqerine tregtare "*Laser Dermatology Clinic* " *sh.p.k*

THEMELUESIT

Znj. Blerina Zeneli Gjinolli

Blerina Zeneli Gjinolli

Tirane 01/07/2021